



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

PROÇESVERBAL

Nr. 16, datë 02.08.2022

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës për muajin gusht, që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:00

Data e mbajtjes së mbledhjes : 02.08.2022

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje Jashtë Radhe

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Zëvendëskryetari e Bashkisë z. Gentian Kallmi dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Ani Dyrmishi: Përshëndetje !

Të nderuar Këshilltarë! I nderuar Zëvendëskryetar! Të nderuar të Pranishëm!

E deklaroj të hapur këtë mbledhje jashtë radhe të Këshillit Bashkiak Durrës për muajin gusht. Në këtë mbledhje do të shqyrtojmë dhe miratojmë mbi projektvendime të propozuara nga Kryetarja e Bashkisë.

Meqë sekretarja e këshillit për arsye shëndetësore nuk e ka të mundur prezencën dhe në vënd të sekretares e zëvendëson këshilltari me moshën më të vogël në sallë, që është Periana. Atëherë Periana, të ftoj të bësh prezencën e këshilltarëve.

Periana Kotri: Jolanda Mustafaraj ... prezent.....deri tek.... Morena Boja...prezent.

28 këshilltarë.

p.s. Hyn me vonesë dhe 3 këshilltarë (P. Bardhaj, A. Hatellari, A. Mullaraj) gjatë rendit të ditës dhe pikave, pra - 31 këshilltarë të pranishëm në sallë.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojmë me rendin e ditës. Sot për shqyrtim e miratim kemi 2 (dy) pika në rend dite.

Pika 1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR KRIJIMIN E SUBJEKTIT TË KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE DATË 28.06.2022, LIDHUR NDËRMJET BASHKISË DURRËS DHE MINISTRISË SË ENERJISË DHE INFRASTRUKTURËS DHE BASHKIVE SHIJAK, KRUIË, KAVAJË, RROGOZHINË
Pika 2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.116, DATË 30.09.2021 “ PËR DETAJIMIN E FONDIT TË PËRFITUAR NË ZBATIM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.514, DATË 18.09.2021 “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E ZBATIMIT, MBIKËQYRJES DHE KOLAUDIMIT PËR REHABILITIMIN E INFRASTRUKTURËS SË RRJETIT TË KULLIMIT NË ZONËN E PORTO ROMANOS – KËNETË DHE SISTEMIMIN E RRJETIT TË UJËRAVE TË SHIUT NË ZONËN URBANE TË QYTETIT TË DURRËSIT DHE CAKTIMIN E BASHKISË DURRËS SI NJËSI ZBATUESE”

Përsa i përket rendit të ditës kemi ndonjë koment?

Atëherë nuk ka komente.

Morena Boja : Kam unë.

Ani Dyrmishi : Po.

Morena Boja : Përshëndetje !

Unë në fakt kisha disa pyetje përse i përket të dyja pikave. Nëse t’i bëj tani apo në fund të çdo pike?

Ani Dyrmishi : Nëse ke koment për rendin e ditës bëje tashi, nëse ke për pikat i bën kur të kalojmë pikat.

Morena Boja : Ok, atëherë kur të trajtojmë pikat.

Ani Dyrmishi : Atëherë koment tjetër ?

Nuk ka.

Kush është pro miratimit të rendit të ditës?

Atëherë Flutura pro ?

Flutura Kasa : Pro, pro.

Ani Dyrmishi : Kundra?

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 29 vota pro miratohet rendi i ditës, se erdhi dhe Pamela.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit të **pikës 1**, i japim fjalën Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike z. Artion Beqiraj.

Artion Beqiraj : Përshëndetje.

Si Komisioni Ligjor për shqyrtimin e pikës 1 të rendit të ditës gjykojmë se në pikën 2 të projektvendimit ka nevojë për një ndreqje ku është parashikuar, pika 2 po citoj : “ *Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Durrës në cilësinë e tij si Aksionar i vetëm....dhe vazhdon fjalia*”, sugjerimi ynë është që të bëhet ndryshim tek togëfjalëshi “i vetëm”, pasi Bashkia Durrës nuk është Aksionar i vetëm pranë kësaj shoqërie dhe ky togëfjalësh të zëvendësohet “*si Aksionar me pjesën takuese....*”. Ky është sugjerimi që të kaloj kjo pikë. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Pra , është kuorumi me këtë propozim, që të kaloj?

Artion Beqiraj : Po, tek pika 2 e projektvendimit.

Ani Dyrmishi : Atëherë koment tjetër ?

Po Morena.

Morena Boja : Unë kisha disa dilema më këtë pikë të rendit të ditës, në lidhje me rolin e bashkisë në këtë marrëveshje, pra kemi krijuar këtë marrëveshje midis Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës me bashkitë përkatëse, por thuhet që ka dhe aktor privat. Doja të dija cili është kontraktori privat që do të angazhohet në këtë marrëveshje? Cili është roli i bashkisë? Pra, pak më transparent përsa i përket rolit të bashkisë, se në relacion thuhet që do të zgjidhen aksionerët, kryetarja e bashkisë do të jetë aksionere me përqindjen që i takon bashkisë Durrës, por nuk ka një përshkrim të detajuar përsa i përket rolit të bashkisë në këtë marrëveshje.

Dhe e dyta që nëse “Ne” diskutojmë për autonominë vendore, në opininin tim nuk është normale që të centralizohet Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve tek Ministria dhe Bashkia të ketë një përqindje relativisht të ulët, në krahasim me rolin që ka tashi tek Ujësjellës-Kanalizime. Pra, nëse flasim për autonominë vendore dhe centralizojmë Ndërmarrjen e Ujësjellës-Kanalizimeve duket që janë dy gjëra të kundërta. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Po Nënkyetar .

Gentian Kallmi : Përshëndetje !

Faleminderit për pyetjen.

Atëherë përsa i pëket pyetjes Tuaj është një marrëveshje e diktuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës. Gjithsesi për çdo detaj teknik të mundshëm do t’Ju mundësojmë me shkrim një

relacion të detajuar në lidhje me akt-marrëveshjen dhe gjithë historikun ku normalisht do ta keni të përfshirë në relacionet që Ju keni.

Morena Boja : Faleminderit .

Pasi siç e thashë relacioni ishte shumë i vakët dhe nuk jep informacion për rolin që ka bashkia e Durrësit në këtë marrëveshje, pra cilat janë fuqitë që ka bashkia e Durrësit dhe pse duhet ta miratojmë “Ne” si Këshill Bashkiak këtë marrëveshje. Sepse në opinionin tim dhe nga pikëpamja ekonomike “Ne” i heqim të ardhura bashkisë së Durrësit me kalimin e ujëshellës-kanalizimeve në këtë marrëveshje midis ministrisë dhe kompanive të përfshira.

Gentian Kallmi : Çdo pyetje do sqarohet.

Morena Boja : Ok

Artion Beqiraj : Të bëj një sqarim.

Ani Dyrmishi : Po.

Artion Beqiraj : Nga ana juridike flas për subjektin privat që bën pjesë në këtë çështje, në pikëpamjen time nuk ka sesi të jetë pjesë, pasi janë përcaktuar se cilët do jenë aksionarët që janë bashkitë Durrës, Shijak, Krujë, Kavajë, Rogozhinë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës. Aktualisht në formën e mëparshme ishin bashkitë Durrës, Krujë, Kurbin disa bashki që preken nga burime uji dhe nga furnizimet e tij, formë e cila ishte krijuar diku në 2015, kërkoj ndjesë për vitin. Ka një gjë, që roli i bashkisë do të jetë në pozicionin e aksionarit dhe ligji e përcakton se cilat janë pozitat e aksionarit. Natyrisht ndryshon përqindja e aksionarit, pasi një pjesë më të madhe në mazhorancë 51 %, sipas akteve e merr ministria. Në pikëpamjen ligjore nuk shikoj ndonjë problem, ky është mendimi im, sepse nënkuptojmë që është një shoqëri e cila ka shumë problematika në menaxhim, por ka dhe shumë detyrime. Pjesëmarrja me kuotë më të lartë automatikisht sjell dhe detyrime më të larta dhe përveç kësaj pra ato që t’i merr përsipër, sepse ndodhin gjatë jetës së një kompanie, siç është kjo sh.a, por nga ana tjetër ka ardh një fazë që ka nevojë për investime dhe këto investime nuk përballohen dot nga pushtetet vendore. Për më tepër që të marrësh kredi nga Banka Botërore apo BERZH apo institucione të tjera duhen aktorë të fuqishmë që garantojnë siç janë ministrinë apo buxheti i shtetit. Në këtë pikëpamje juridike-ekonomike siç e shikoj unë formula është e mirë, ajo garanton një afat 10 (dhjetë) vjeçar, pasi i jep garanci dhe subjekteve që do të financojnë këto investime, pasi ka mbrapa subjekte që janë rentabël, që mund ta shlyejnë këtë detyrim.

Morena Boja : Ok, faleminderit. Unë nuk kisha komente përse i përket anës juridike të krijimit të kësaj shoqërie të përbashkët, okey nga pikëpamja juridike është në rregull . Ne po flasim për autonominë vendore dhe dëmin ekonomik që i shkakton bashkisë së Durrësit kjo marrëveshje midis Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës me bashkive përkatëse, pra pse të jemi bashkë

me bashki të tjera ndërkohë që “Ne” mund ta menaxhojmë shumë mirë vetë, mendoj unë, mbase me një projekt të rishikuar, pra në mënyrë tjetër, kjo është ideja.

Artion Beqiraj : Jemi me bashki të tjera aktualisht ose në bazë të vendimit të këshillit bashkiak, siç e thashë, Laçi se s’ më kujtohet , pasi varet nga rrjedha e ujit dhe rrjeti furnizimit, pasi nëse rrjeti kalon në disa bashki dhe banorët e tyre furnizohen, do të thotë që t’i i merr arkëtimet, atëherë dhe ata do të jenë pjesë. Pra, bashkia s’ka qënë asnjëherë e vetme, bashkia ka qënë pjesmarrëse bashkë me disa bashki të tjera dhe në këtë rast ndryshimi është që shtohet dhe një aksionar tjetër që është ministria. Pikëpamja autonomisë vendore, ky është një diskutim nuk e di pastaj dhe mund ta flasim, autonomi vendore kur nuk e përballon detyrimin, duhet parë kështu, pasi nuk e kuptoj nëse t’i e ke thjesht si të përgjithshme pyetjen apo ke diçka specifike. Po të thuash ka cënim, kjo është e përgjithshme.

Morena Boja : Ideja është që “Ne” të mos heqim nga bashkia ato subjekte, që i krijojnë të ardhura, sepse janë dy koncepte siç e shtrova dhe më përpara, që nuk korrespondojnë me njëra tjetrën, pra nëse unë i heq të gjitha subjektet që krijojnë të ardhura do të thotë që unë s’ mund të kem autonomi vendore dhe të varem në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga buxheti i shtetit dhe nga transfertat qeveritare, këtë mendoj unë.

Artion Beqiraj : Në pikëpamjen time, e zëmë se nuk jam i saktë në shifra, nëse bashkia Durrës ka 70 % , ose 70.4 mesa kujtoj , nesër po them do ketë 40, por do këtë 40 % të një volumi më të madh investimi dhe arkëtimeve dhe jo automatikisht kjo përkthehet në humbje, ndërkohë 70 % e një kompanie, e cila ka humbje dhe kërkon investime është më e madhe cënimi.

Morena Boja : Pra duhet një relacion më transparent me përfitimet ekonomike aktuale të ujësjellësit dhe si do i riorganizojë të ardhurat kjo marrëveshje midis ministrisë dhe bashkive përkatëse.

Artion Beqiraj : Ka një Vendim të Këshillit të Ministrave për pjesmarrjen në aksione, por unë si këshilltarë se marr përsipër të sqaroj anën ekonomike siç e tha dhe nënkryetari, pasi ato i përkasin menaxhimit.

Morena Boja : Ok, faleminderit.

Valentino Mustaka : O zotëri ju e keni parë nga ana juridike këtë problem, tashi ujin Durrësi do duhet t’ja japi Kavajës, kurse Tirana i merr plazhin Kavajës. Nuk është e drejtë, kjo është kundra ligjit për mu. Kavaja me të madhe iku nga Durrësi, të shkoj të furnizohet nga ujësjellësi i Tiranës. Ç’punë ka Kavaja tek neve, apo të ngelim pa ujë fare tashi.

Artion Beqiraj : Jo, jo Durrësi nuk ka burim uji, prandaj e marrim nga bashkitë e tjera.

Valentino Mustaka : E di unë, se unë kam qënë ai që e kam sjellë nga fushë kuqa këtu, nuk më mëson ti mu. Unë them nga ana juridike, Kavaja është në juridiksion të Tiranës, nuk ka punë me Durrësin. Ju bëni ça të doni re, vini kazmën ujësjellësit.

Artion Beqiraj : S'ka lidhje fare kjo.

Valentino Mustaka : Jo, meqë po e shikoni nga ana juridike .

Ani Dyrmishi : Komente të tjera ka?

Valentino Mustaka : Dhe është shumë e gabuar.

Ani Dyrmishi : Valentino, të lutem tashi.

Komente të tjera ka?

S'ka.

Atëherë Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Zamira Mustafaraj.

Zamira Mustafaraj : Përshëndetje!

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike votoi unanimisht për ta kaluar këtë pikë.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Atëherë kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstënim ?Nuk ka.

Atëherë me 3 apstënim dhe 27 vota pro miratohet dhe pika 1 e rendit ditës me gjithë ndryshimet që propozoi Artioni.

- Kalojmë në shqyrtimin për **pikën 2** i japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave znj. Pamela Bardhaj.

Pamela Bardhaj : Faleminderit Kryetar.

Komisioni ynë vendosi pro miratimit të kësaj pike.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Bardhaj.

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

Etleva Velçani : Faleminderit Kryetar.

Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës pasi mori në shqyrtim relacionin dhe projektvendimin propozon kalimin në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Ka ndonjë koment përsa i përket pikës 2 të rendit të ditës?

Morena Boja : Po, kisha unë një koment.

Një pyetje për relacionin . Edhe në këtë rast relacioni nuk është shumë i detajuar.

Unë doja të dija se pse ky fond prej 700 milion lekësh të reja kalohet për kanalizimet në Porto - Romano dhe ish-Kënetë, ndërkohë që është një fond për procesin e rindërtimit?

Mendoj që kjo fazë që jemi në procesin e rindërtimit nuk ka pse t'i kalojnë fonde procesit të kanalizimeve, sepse e dimë shumë mirë që është i papërfunduar, ka problematika dhe janë pa fund qytetarë që janë akoma jashtë

Ani Dyrmishi : Po Nënkyetar .

Gentian Kallmi : Faleminderit dhe njëherë për pyetjen.

Zbatimi i projektit për rindërtimin e hidrovorit është një projekt-zbatim në kuadër të procesit të rindërtimit me fonde nga Ministria e Rindërtimit dhe e financuar plotësisht nga Ministria e Rindërtimit, që do të thotë që është një objekt në kuadër të procesit të rindërtimit, i klasifikuar me nivel dëmi DS5 nga procesi i rindërtimit.

Morena Boja : Unë në fakt doja një raport të projektit, pra për të justifikuar shifrën që është investuar deri tani, pasi pika 2 e rendit të ditës është ndryshim i një vendimi të mëparshëm ku shumës së mëparshme që keni paguar i shtohet dhe kjo shumë prej 700 milion lekësh të reja. Nëse është e mundur do të doja të dhënat justifikuese për këto shifra që është investuar në hidrovor, kompanitë e përfshira ose më të detajuar, pasi kështu si sillen relacionet është e vështirë për t'i lexuar “Ne” dhe jo më persona të tjerë që s’kanë informacion.

Gentian Kallmi : Atëherë projekti i zbatimit, që është me një vlerë të caktuar dhe financimi i zbatimit është ndarë në disa faza. Fondi që miratohet sot në Këshill Bashkiak është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave dhe është në vazhdimësi të fondit total të zbatimit të projektit.

Morena Boja : Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Koment tjetër ka?

Nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 2 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Më fal Morena ishte kundra.

Morena Boja : Pro.

Ani Dyrmishi : Atëherë me 31 vota pro miratohet dhe pika 2 e rendit ditës.

Ani Dyrmishi: Duke qënë se kjo është mbledhje jashtë radhe, nuk ka pyetje.

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Do të njoftoheni në rrugë elektronike nga sekretaria e këshillit për mbledhjen e radhës

Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 8 (tetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit, sipas Rregullores Këshillit dhe Procesverbalit të Kryesisë dhe 2 Kryetarëve të Grupeve Politike në Këshill së datës 09.06.2022.

Mbajtësi i procesverbalit: Periana Kotri

Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Zëvendëskryetare e Këshillit :

ZAMIRA MUSTAFARAJ

Këshilltare e Këshillit Bashkiak :

PERIANA KOTRI

Kryetar i Grupit të Partisë Socialiste të KB :

AFRIM BAKAJ

Kryetar i Grupit të Pavarur të KB :

ETLEVA VELÇANI